



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS
NR. 1160 PROT.
DATA 15.05.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE

Nr. 15 Prot.

Vlorë më, 15/05/2024

VENDIM

Nr. 3, datë 15.05.2024

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË FAKULTETIT
TË SHKENCAVE HUMANE**

Në zbatim të nenit 42 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 21 e pikës 4 nenit 25 të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë", Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Shkencave Humane verifikoi dokumentacionin e kandidatëve për Drejtues në Fakultetin e Shkencave Humane.

Me shkresën nr. 1140/1 prot., datë 15.05.2024 të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore vihemi në dijeni për dokumentacionin e kandidatit për Drejtues të Fakultetit të Shkencave Humane, Z. Roland Mitro Zisi. Në përputhje me aktet ligjore më sipër kandidati Z. Roland Mitro Zisi zotëron titullin akademik "Profesor" dhe ka eksperiencë në mësimdhënie 10 vite.

Me shkresën nr. 1139/1 prot., datë 15.05.2024 të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore vihemi në dijeni se kandidati për Drejtues të Fakultetit të Shkencave Humane, Z. Roland Mitro Zisi nuk ka masë disiplinore në dosje.

Në përfundim Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Shkencave Humane pas verifikimit të dokumentacionit,

VENDOSI:

1. Miratimin e kandidimit të Z. Roland Mitro Zisi për Drejtues të Fakultetit të Shkencave Humane.
2. Vendimi publikohet në të gjitha mjediset e Fakultetit të Shkencave Humane dhe në faqen zyrtare elektronike të universitetit: www.univlori.edu.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE

Deniz ÇUPI (Anëtare)

Migena MEMAJ (Anëtare)

KRYETAR
Klajdi MONE